



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT

Nga procesverbali i mbledhjes së 23-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 27. 05. 2020, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 14,⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Skender Bikliqi, Kryesues i Komitetit për Komunitete
2. Naim Jahiri
3. Lulzim Rustemi
4. Egzona Fazlija
5. Arben Salihu
6. Ferat Gashi
7. Slavisa Trajkovic
8. Zoran Çirković
9. Franjo Goleme

Të tjerë prezent

1. Lulzim Qerimi, nënkryetar i komunës për komunitete
2. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**,

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Skender Bikliqi, përshëndeti të pranishmit dhe tha shqyrë zotit që të gjithë jeni mirë po ashtu edhe në familjet e juaja janë mirë dhe pas një kohe po vazhdojmë me punë.

Në vazhdim tha se rendin e ditës e keni marrë dhe pyeti a ka dikush vërejtje apo plotësime?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Komiteti për punën e kësaj mbledhje unanimisht aprovoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 22-të e Komitetit për Komunitete.
2. Informatë lidhur me pandeminë COVID- 19 në Komunën e Lipjanit
3. Raporti i punës së ZLK-së,
4. Të ndryshme

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 22-të të Komitetit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, pyeti anëtarët e Komitetit, se a ka dikush vërejtje, apo plotësime, në ekstraktin nga mbledhja e 22-të?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit, konstatoi se Komiteti unanimisht.

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 22-të të Komitetit për Komunitete

Shtesë: Ekstrakti.

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës.

II

Informatë lidhur me pandeminë COVID- 19 ne Komunën e Lipjanit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, i dha fjalën Lulzim Qerimit, Nënkyetar i Komunës për Komunitete, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Informata.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Zoran Çirkovic, e falenderoj Nënkyetarin për bashkëpunimin që kemi pasur gjatë pandemicë COVID-19. Po ashtu kemi pasur bashkëpunim edhe me Sllavishen dhe komuniteti ynë është ndihmuar nga komuna me maska, dorëza e pako ushqimore.

Ne kemi pasur aktivitete ku rekomandimet të cilat i ka dhënë ministria ne i kemi bërë kopje në ZLK dhe ua kemi shpërndarë komunitetit që të jenë sa më shumë të informuar. Po ashtu një pjesë e komunitetit kanë filluar t'i marrin mjetet e Qeverisë në shumë prej 130€. Edhe njëherë them se jemi të kënaqur me bashkëpunimin që kemi pasur me Nënkyetarin.

Slavisa Trajković, në emër të komunitetit serb ju falenderoj për bashkëpunimin që kemi pasur me Nënkyetarin e komunës goftë kontakt ditorë apo përmes telefonit dhe kemi bërë një punë të mirë. Shpresojmë që të vazhdojë bashkëpunimi edhe më tutje dhe shpresojmë të mos na përsëritete kjo pandemi. Po ashtu falënderojmë edhe UNMIK-un dhe OSBE-në për bashkëpunimin që kemi pasur.

Lulzim Rustemi, po më vjen mirë që jemi së bashku të gjithë dhe jemi shëndosh e mirë ne dhe familjet tona.

Lipjani është njëra ndër komunat që ka kaluar më së miri me përjashtim Janjeva që ka qenë në situatë pak më të vështirë pasi që gjatë karantinës qytetarët nuk kanë mundur që t'i marrin asistencën sociale e as pensionet. Ne si Kuvend kemi pasur dy takime ku janë ndarë 170 mijë euro dhe me këto mjete shpresojmë që me pako ushqimore të jetë përfshirë edhe Janjeva.

Franjo Goleme, po më vjen mirë që po takohemi prap. Unë nuk kam pasur bashkëpunim me askënd nga komuna përveq me Skenderin dhe nuk e dija a ka pasur ndonjë pako ushqimore për komunitetin kroat pasi që mua nuk më kanë njoftuar askush. Unë më nuk do të marrë pjesë në takimet e komitetit.

Lulzim Qerimi, unë nuk kam kontaktuar me Franjon por kam kontaktuar me Josipin që është zyrtarë komunal nga komuniteti kroat po ashtu edhe me Don Matej dhe kemi pasur bashkëpunim të vazhdueshëm.

Ferat Gashi, është e vërtetë që kanë ardh shumë pako në Janjevë por ka pas familje që ka marrë 3 ose 4 herë. Ka mundur që të punohet më mirë dhe të ketë bashkëpunim me neve.

Naim Jahiri, falë Zotit që ne jemi mirë dhe si komunë kemi kaluar mire ku i falenderoj të gjithë ata të cilët u angazhuan gjatë kësaj pandemie siç janë: stafi shëndetësorë, Shtabi emergjent etj. Në veçanti Shtabin të cilët kanë kryer një punë shumë të mirë ku nëse ndonjë familje e kemi ditë që kanë nevojë për ndihmë veç e kemi njoftuar Shtabin dhe brenda pak kohe Shtabi ju ka dërgu pakot ushqimore.

Skender Bikliqi, unë çdo ditë kam dalur të kontaktoj me qytetarët e Janjevës dhe me Nënkryetarin kemi pasur bashkëpunim. Gjatë karantinës ne si Janjevë jemi bllokuar shumë pasi që nuk kemi mundur të dalim as të marrim asistencën sociale as pensionet e as të furnizohemi me ushqim dhe këtu është bërë gabim që është hy në karantinë e gjithë Janjeva për shkak të një personi është dashtë të izohet vetëm ajo familje e jo e gjithë Janjeva. Po ashtu nuk kemi pasur bashkëpunim as me kryetarin e fshatit e as me këshillin e fshatit dhe ne nuk e dijmë se kush i ka pru ata emra në komunë.

Arben Salihu, shyqyr Zotit që jemi mirë, është dashur që të ketë bashkëpunim më të mirë në mes të këshillit të fshatit dhe kryetarit të fshatit dhe komunës.

Meqë diskutime të tjera nuk pati rreth kësaj pike, u kalua në pikën e radhës.

III

Raporti i punës së ZLK-së

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, i dha fjalën Radmilla Simionoviq, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Naim Jahiri, e falenderoj Radmillën për bashkëpunimin por kam një pyetje një banor nga fshati Sllovi ka bërë një kërkesë për shtëpi deri ku ka shku procedura.

Radmilla Simionoviq, kërkesa na ka ardh por do të bëhet një komision që do ta vlerësoj atë.

Meqë diskutime të tjera nuk pati rreth kësaj pike u kalua në pikën të ndryshme

IV

Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Skender Bikliqi, tha se a ka dikush të diskutoj rreth kësaj pike.

Lulzim Qerimi, ju njoftojmë se nga program ROMA ACTED Komuna e Lipjanit ka përfituar dy projekte të cilat do të fillojnë së shpejti, ndriqimi publik në fshatin Medvec si dhe renovimi i qendrës rinore në Janjevë. Po ashtu komuna është duke hartuar planin tre vjeçar të banimit ku do të kemi bashkëpunim edhe me VORE-n.

Nga e enjëta do të filloj shpërndarja e shportave të mbeturinave në Janjevë.

Skender Bikliqi, e falenderoj Nënkryetarin së bashku me Arbenin të cilët na ndihmuan dhe falë tyre ambulanca në Janjevë tani ka ujë.

Ferat Gashi, në Janjevë në pjesën e naltë të fshatit nuk ka ujë hiq.

Zoran Çirkovic, në fshatin Grackë një familje ka një problem po thuaj se qe dy vite ku për shkak të kanalizimit i cili ka dalur në arën e ti ai nuk mund ta punoj gjysmën e arës.

Lulzim Qerimi, sa i përket mirëmbajtjes së kanalizimeve përgjegjësinë tani e ka kompania e ujësjellësit.

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 16¹⁵.

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit
Skender Bikliqi